



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Datë: 27/07/2023

Ref: 548/2023

E nderuara familje Mulliqi,

Me dhimbje të thellë morëm lajmin për ndarjen nga jeta të më të dashurit tuaj, Prof. Dr. Haqif Mulliqi.

Ai shkroi shumë drama e tekste tjera artistike, kritika për teatrin, dramën e filmin, të gjitha kontribute të tij me numra të lartë sepse angazhimi i tij ishte i pandalshëm. Ai e ndërtoi veten vazhdimisht duke ndërtuar dhe mirëmbajtur rubrika të reja në gazetari. Ai i studioi klasikët, e njohu mirë karakterin e tyre e krahas kësaj edhe qytetarët të cilët i takoi nëpër skenat e shumta të gati çdo qyteti shqiptar. E deshi lirinë, dijen dhe artin. Këto dashuri e ngrenë lartë si qenie të angazhuar, për të cilat sot e nderojmë dhe kujdesemi që të kujtohet. Megjithëse u nda herët nga të dashurit dhe lexuesit e tij, jeta e tij artistike ishte e gjatë prandaj do ta lexojmë e kujtojmë gjatë.

Prof. Dr. Mulliqi përveç kontributit në fushën e kulturës, u bë i njohur edhe si reporter i luftës, ku dha një kontribut të çmuar në prezantimin dhe mbulimin e ngjarjeve gjatë periudhës së luftës. Për këtë, ai do të mbahet mend si një njeri që përveç si profesor, dëshmoi atdhedashurinë në të gjitha format e saj.

Trashëgimia në art, gazetari dhe universitet që Prof. Dr. Mulliqi la pas vetes do të jetë një shembull i mirë për gjeneratat e reja.

Ngushëllimet më të sinqerta për familjen, komunitetin artistik dhe atë të gazetarëve. I përhershëm qoftë kujtimi për të!

Sinqerisht,

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës